



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLIKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
 Data 04-07-2018

P.nr.2206/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtari i vetëm gjykes Ilir Bytiqi, me bashkëpunëtoren profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED], Komuna e Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.972-7/2017, e dt.05.09.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më dt. 21.05.2018, mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP.II.nr.972-7/2017, e dt.05.09.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

[REDACTED] i biri i [REDACTED], i lindur më [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] me profesion bukje Komuna e Ferizaj, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 29 Prill 2017, rreth orës 14:00h, në Ferizaj, në parkingun e qendrës tregtare "ETC" me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje në dëm të dëmtuarit [REDACTED] në atë mënyrë që nga bodrumi i qendrës tregtare "ETC", vjedhë biçikletën me ngjyrë të zeze në vlerë prej 100 Euro, e cila më datë 04.05.2017 është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor dhe të nesërmen i është kthyer të dëmtuarit.

me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 par. 1 të KPPRK-së, e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej 200€ (dyqind/euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzet/euro) të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, P.II.nr.972-7/2017, e dt.05.09.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënie-lëshimin e urdhrit ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve edhe atë deklaratën e të pandehurit [REDAKTUAR] dt. 04.05.2017, vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve dt. 04.05.2017, vërtetimin mbi kthimin e sendeve dt. 05.05.2017, dhe erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënie e urdhrit ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.


Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
P.nr.2206/17 e dt.21.05.2018

Bashkëpunorja profesionale
Mimoza Shabani

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.